



qendra e provimeve

MASA

E VËRTETË

E NJOHURIVE

GARAT SHTETËRORE

2019

SHIFRA E NXËNËSIT

SHKOLLA FILLORE, KLASA VI

MATEMATIKË

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PIKËVE TË FITUARA



Testin e kontrollloi

.....

.....

Podgoricë, 20.....

UDHËZIM PËR PUNË

Të dashur nxënës dhe nxënëse,

Urime! Keni arritur që të vini në garat shtetërore nga matematika dhe me këtë hap keni arrite një sukses të madh. Prandaj detyrat që janë para jush shikoni si një problem interesant dhe përpiquni që t'i zgjidhni me një kujdes dhe angazhim të plotë, por edhe me një kënaqësi.

Renditja e punimit të detyrave nuk ka rëndësi. Nëse ndonjë detyrë ju duket shumë e vështirë, mos u ndalni shumë në të, por kaloni në detyrën tjetër. Nëse ju mbetet kohë, kthehuni dhe provoni t'i zgjidhni përsëri ato detyra të cilat nuk i keni zgjidhur.

Shkruani lexueshëm, posaçërisht numrat!

Punoni në mënyrë të pavarur. Nuk lejohet asnjë lloj bashkëbisedimi. Nëse ndokush në ndonjë mënyrë pengon punën, do të përjashtohet nga garat.

Gjatë punës mund të shfrytëzoni veglat shkollore për vizatimin e figurave gjeometrike, por nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë, kalkulatorëve dhe mjeteve tjera ndihmëse elektronike.

Për çdo detyrë janë paraparë nga 25 pikë.

Për punë keni 180 minuta.

Mund të filloni nga puna.

Me fat!

1. Për tre minuta nga çezma A dalin 2 litra ujë. Për gjashtë minuta nga çezmat A dhe B dalin gjithsej 13 litra ujë. Përderisa nga çezma B del një litër ujë, nga çezma C dalin 2 litra ujë. Sa litra ujë do të dalin gjithsej nga çezmat A dhe C për tre minuta?

2. Numri më i vogël i thjeshtë më i madh se numri i dhënë natyror quhet *pasardhësi i thjeshtë* dhe shënohet me \dot{n} . Ja disa shembuj të pasardhësve të thjeshtë: $\dot{6} = 7, \dot{9} = 11, \dot{13} = 17$. Përcaktoni pesë shifrat e fundit të prodhimit të të gjithë pasardhësve të thjeshtë nga tabela e dhënë.

$\dot{1}$	$\dot{2}$	$\dot{3}$	$\dot{4}$	$\dot{2019}$
$\dot{1}$	$\dot{2}$	$\dot{3}$	$\dot{2019}$	$\dot{5}$
$\dot{1}$	$\dot{2}$	$\dot{2019}$	$\dot{4}$	$\dot{5}$
$\dot{1}$	$\dot{2019}$	$\dot{3}$	$\dot{4}$	$\dot{5}$
$\dot{2019}$	$\dot{2}$	$\dot{3}$	$\dot{4}$	$\dot{5}$

3. Para disa vitesh pranë një ulliri të vjetër në periferi të Tivarit është mbjellë ulliri i ri. Do të duhet që ulliri i ri të bëhet gjashtëdhjetë e gjashtë herë më e vjetër se është tani që të jetë dy herë më i ri se ulliri i vjetër, ndërsa vitin e kaluar ulliri i ri ka qenë madje njëqind herë më i ri se i vjetri. Sa vjet kishte ulliri i vjetër kur është mbjellë ulliri i ri?

4. Për nevojat e projektit të veçantë grupi i arkitektëve punon rrjeta teli në formë të kuadrit që duken si të ishin punuara nga kubi me brinjë 1cm. Në fotografi është një rrjetë e tillë e gjere dy kuba, e gjatë dy kuba dhe e lartë 1 kub. Një rrjetë që e kanë punuar arkitektët është e përbërë nga 37 kube. Sa tel kanë përdorur në punimin e asaj rrjete?



